

# RELACION

## PËR

### PROJEKTLIGJIN “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998, “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR”

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Propozimi i projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar” është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, e 155, të Kushtetutës.

Ky projektligj synon:

- rritjen e pagës dysHEME të patatueshme për të ardhurat nga paga në intervalin nga 30,001 lekë/muaj deri në 40,000 lekë/muaj. Për këtë interval pagash tatimi që do të paguhet mbi të ardhurat nga paga është 0%, duke mundësuar që çdo qytetar që siguron më pak të ardhura të mos paguajë tatim mbi të ardhurat nga paga.
- reduktimin e normës tatimore me 50% për tatimpaguesit me të ardhura nga paga nga 40,001 lekë/muaj deri në 50,000 lekë/muaj. Këta tatimpagues do paguajnë 0% tatim deri në shumën 30,000 lekë të ardhura mujore nga paga, dhe mbi këtë shumë do paguajnë gjysmën e normës tatimore prej 13% (pra  $50\% * 13\%$ ). Kjo siguron që qytetarët me më pak të ardhura të paguajnë tatim më të ulët mbi të ardhurat nga paga.
- mbështetjen e shtresës së mesme, duke rishikuar fashën e sipërme të taksimit progresiv. Tatimi 23% parashikohet të fillojë të aplikohet në pagat mbi 200,000 lekë/muaj, nga 150,000 lekë/muaj që është aktualisht.

#### **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektligj nuk është parashikuar në programin analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2021.

#### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Ky projektligj është hartuar në kuadër të plotësimit të parashikimeve të përcaktuara në programin qeveritar, në të cilin theksohet se, çdo qytetar që

siguron më pak të ardhura, do të paguajë më pak tatime mbi të ardhurat nga paga, por, kush fiton më shumë, do të kontribuojë më shumë për mirëqenien e përbashkët dhe gjithashtu të mbështetet shtresa e mesme e popullsisë.

Në mënyrë që të lehtësohet barra tatimore e shtresave më në nevojë të popullsisë, është propozuar që tatimpaguesit me të ardhura personale nga punësimi në intervalin nga 30,001 lekë/muaj deri në 40,000 lekë/muaj tashmë të paguajnë 0% tatim, nga 13% tatim që paguanin mbi shumën 30,000 lekë/muaj. Numri i tatimpaguesve që përfitojnë nga ulja e barrës tatimore është rreth 71,500 dhe shuma e përfitimit është mesatarisht 7,800 lekë për tatimpagues/vit ose rreth 557 milionë lekë/vit për të gjithë tatimpaguesit.

Gjithashtu, në të njëjtën linjë, për lehtësimin e barrës tatimore të shtresave në nevojë të popullsisë, me anë të këtij projektligji propozohet që tatimpaguesit me të ardhura nga paga nga 40,001 lekë/muaj deri në 50,000 lekë/muaj, të vijojnë të paguajnë 0% tatim deri në shumën 30,000 lekë/muaj të ardhura nga paga, dhe ndryshe nga regjimi i mëparshëm, mbi shumën 30,000 lekë/muaj të paguajnë gjysmën e normës tatimore prej 13% ( $13\% * 50\%$ ). Numri i tatimpaguesve që përfitojnë nga kjo lehtësi tatimore është rreth 58 000 dhe shuma e përfitimit është mesatarisht 11,700 lekë për tatimpagues/vit ose në total 678 000 000 lekë/vit për të gjithë tatimpaguesit.

Në kuadër të lehtësimit të shtresës së mesme të popullsisë, në këtë projektligj është parashikuar ndryshimi i fashës së sipërme të taksimit progresiv. Tatimi 23% parashikohet të fillojë të aplikohet në pagat mbi 200,000 lekë/muaj, nga 150,000 lekë/muaj që është aktualisht. Numri i tatimpaguesve që përfitojnë nga kjo lehtësi tatimore është rreth 5,900 dhe shuma e përfitimit është mesatarisht 23,000 lekë për tatimpagues/vit ose në total 135 000 000 lekë për të gjithë tatimpaguesit.

E ardhura nga paga në lekë/muaj		E ardhura e tatueshme në lekë/muaj		Norma tatimore në përqindje/mujore
Nga	Deri në	Nga	Deri në	
0	40 000	0	40 000	0%
40 001	50 000	0	30 000	0%
		30 001	50 000	50% * 13% të shumës mbi 30 000 lekë
50 001	Më tepër	0	30 000	0%
		30 001	200 000	13% e shumës mbi 30 000 lekë
		200 001	Më tepër	22 100 lekë + 23% të shumës mbi 200 000 lekë

Në total, barra tatimore ulet me 1.37 miliardë lekë në vit për subjektet që përfitojnë nga ndryshimet e propozuara në këtë projektligj, e cila nga ana tjetër përkthehet në të ardhura të munguara për shtetin në po të njëjtën shumë. Pra, aplikimi i këtyre ndryshimeve ligjore rezulton me një efekt negativ në buxhetin e shtetit prej -1.37 miliardë lekë në vit, ndërsa sa i takon vitit 2022, duke qenë se ky parashikim nis të zbatohet në korrik të vitit 2022, efekti negativ për vitin 2022 parashikohet të jetë -685 milionë lekë.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Projektligji nuk synon përafrimin me ndonjë *acquis* të Bashkimit Evropian.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektligji përbëhet nga 2 nene, të cilat parashikojnë, si më poshtë vijon:

Neni 1, parashikon zëvendësim të pasqyrës nr.1, “Tabela për tatimin mbi të ardhurat personale nga punësimi”, të ligjit.

Neni 2, parashikon hyrjen në fuqi të ligjit.

#### **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ AKTI**

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

#### **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektligji është draftuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Ky projektligj parashikon të sjellë një efekt negativ në buxhetin e shtetit prej -1.37 miliardë lekë në vit. Ndërkohë, sa i takon vitit 2022, duke qenë se kjo politikë do të nisë të zbatohet në korrik 2022, efekti negativ në buxhetin e shtetit për vitin 2022 do të jetë rreth -685 milionë lekë.

### **KËSHILLI I MINISTRAVE**